



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0460

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D. Kryetari I OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi- Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “TRAFFIKS VA SH.P.K.”, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal” me numër të prokurimit 616-26-3854-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SË PRISHTINES, më 19/08/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE TRAFFIKS VA SH.P.K. me nr. 2026/0460 , e datës 05/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal”, me numër të prokurimit 616-26-3854-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.
2. Korigjohet, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal”, me numër të prokurimit 616-26-3854-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas dispozitave të LPP-së.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.05.2026 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal” me nr. të prokurimit: "616-26-3854-2-1-1",

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **450,000.00 €**.

Me 26.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 03.07.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.07.2026, OE TRAFFIKS VA SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0460, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TRAFFIKS VA SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor nr. 1

Shkelja e nenit 53 të LPP-së lidhur me mosdhënien e sqarimeve të plota dhe të arsyetuara

Operatori ekonomik pretendon se më 11.06.2026 ka paraqitur kërkesë për sqarime lidhur me një sërë paqartësish dhe kërkesash kufizuese të përfshira në Dosjen e Tenderit. Sipas pretendimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar asnjërën prej çështjeve të ngritura, por është kufizuar në përgjigjen standarde "Referoju DT-së", pa dhënë arsyetime teknike apo juridike dhe pa eliminuar paqartësitë e evidentuara. Sipas operatorit ekonomik, një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 53 të LPP-së, pasi nuk mundëson interpretim të njëjtë të dokumentacionit të tenderit dhe cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr. 2

Paqartësia e kriterit për angazhimin e inxhinierit të ndërtimtarisë

Operatori ekonomik pretendon se kërkesa nr. 3 e Dosjes së Tenderit, me të cilën kërkohet një inxhinier i ndërtimtarisë ose bachelor, nuk specifikon drejtimin profesional të kërkuar (konstruktiv, hidroteknik apo drejtim tjetër). Sipas operatorit ekonomik, mungesa e këtij

specifikimi krijon paqartësi dhe mundëson interpretime të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave, duke qenë në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së dhe me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Pretendimi ankimor nr. 3

Paqartësia lidhur me mostrat e kërkuara

Operatori ekonomik pretendon se kërkesa nr. 10 e Dosjes së Tenderit kërkon dorëzimin e mostrave për sinjalizimin horizontal dhe vertikal, mirëpo nuk specifikon qartë dimensionet, materialin, karakteristikat teknike apo pamjen e mostrave që duhet të dorëzohen. Sipas operatorit ekonomik, mungesa e specifikimeve të nevojshme pamundëson përgatitjen e një oferte të krahasueshme dhe krijon hapësirë për interpretime subjektive gjatë vlerësimit.

Pretendimi ankimor nr. 4

Kërkesa për pajisjen "SP DL me extruder Dot Line; realizimin e shkronjave prej 50 cm është kufizuese dhe pa bazë teknike

Operatori ekonomik pretendon se Dosja e Tenderit kërkon posedimin e pajisjes "SP DL me Extruder Dot Line Advanced 50 cm", megjithëse në Paramasë dhe Parallogari nuk ekziston asnjë pozicion pune që kërkon përdorimin e teknologjisë "spray plastik", realizimin e shkronjave 50 cm apo pajisjeve "Extruder Dot Line". Sipas operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar nevojën funksionale të kësaj pajisjeje dhe nuk ka identifikuar asnjë pozicion konkret të kontratës që e justifikon kërkesën. Pretendohet se kjo kërkesë është vendosur në kundërshtim me nenet 7, 27 dhe 28 të LPP-së, si dhe nenet 17 dhe 19 të Rregullores nr. 002/2024, pasi kufizon konkurrencën dhe favorizon operatorë të caktuar ekonomikë.

Pretendimi ankimor nr. 5

Dyfishimi i kërkesave në Aneksin 8

Operatori ekonomik pretendon se pika 2 dhe pika 4 e Aneksit 8 përmbajnë përshkrim identik lidhur me rimorkion për sinjalizim rrugor. Sipas pretendimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar nëse bëhet fjalë për një gabim teknik apo nëse kërkohen dy pajisje të ndryshme, duke u përgjigjur vetëm me formulimin "Referoju DT-së". Pretendohet se kjo krijon paqartësi lidhur me numrin e pajisjeve që duhet të posedohen dhe përbën shkelje të nenit 53 dhe nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr. 6

Paqartësia lidhur me aparatën special termoplastik

Operatori ekonomik pretendon se kërkesa për "aparat special termoplastik për matjen e trashësisë së termoplastikës" nuk përmban asnjë përshkrim teknik që identifikon llojin e pajisjes, karakteristikat apo funksionin e saj. Sipas operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë sqarime konkrete dhe ka lënë në fuqi një kërkesë teknikisht të paqartë, në kundërshtim me nenet 7 dhe 53 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr. 7

Kërkesa që makina mekanike të aplikojë tri vija njëkohësisht është e paarsyetuar

Operatori ekonomik pretendon se Specifikimet Teknike kërkojnë që makina për shënimin e rrugëve të jetë në gjendje të aplikojë së paku tri vija njëkohësisht, pa u identifikuar asnjë pozicion në Paramasë dhe Paralogari që kërkon një funksionalitet të tillë. Sipas pretendimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar arsyetim teknik dhe për këtë arsye kërkesa bie ndesh me nenet 7, 27, 28 dhe 53 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr. 8

Kërkesa për testimin fizik të pajisjeve është diskriminuese

Operatori ekonomik pretendon se kërkesa që pajisjet të testohen në prezencë të komisionit gjatë fazës së vlerësimit krijon barrë të panevojshme financiare, veçanërisht për operatorët që posedojnë pajisje të marra me qira nga shtete të tjera. Sipas operatorit ekonomik, një kërkesë e tillë bie ndesh me nenin 1 të LPP-së lidhur me përdorimin efikas të fondeve publike, si dhe me nenin 55 të LPP-së dhe nenin 76 të Rregullores për Prokurimin Publik, pasi verifikimi mund të realizohet edhe përmes mjeteve elektronike.

Pretendimi ankimor nr. 9

Përfshirja e standardeve EN pa lidhje me objektin e kontratës

Operatori ekonomik pretendon se standardet EN 12966, EN 12352, EN 12368 dhe EN 12675 janë përfshirë në Specifikimet Teknike, megjithëse Paramasa dhe Paralogaria nuk përmbajnë pozicione pune që lidhen me sistemet VMS, semaforët apo pajisjet ndriçuese. Sipas operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar lidhjen ndërmjet këtyre standardeve dhe objektit të kontratës, duke krijuar paqartësi dhe kufizim të konkurrencës.

Pretendimi ankimor nr. 10

Referimi në akte nënligjore të shfuqizuara ose kontradiktore

Operatori ekonomik pretendon se Dosja e Tenderit referon njëkohësisht akte nënligjore të ndryshme, përfshirë dispozita që sipas tij janë shfuqizuar, pa përcaktuar qartë bazën juridike të zbatueshme. Sipas pretendimit, Autoriteti Kontraktues nuk ka korrigjuar dokumentacionin dhe nuk ka dhënë sqarime konkrete, duke cenuar sigurinë juridike dhe duke vepruar në kundërshtim me nenet 7 dhe 53 të LPP-së, si dhe nenet 17 dhe 19 të Rregullores nr. 002/2024.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Duke u mbështetur në nenin 108/A të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/1-237, Ligjin Nr. 05/L-0G8 dhe Ligjin Nr. 05/1-092,, si operator ekonomik me interes për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj dokumentacionit të tenderit dhe sqarimeve shtesë të publikuara nga Autoriteti Kontraktues më 22.06.2026. Më datë 11.06.2026 kemi parashtruar kërkesë për sqarime lidhur me një sërë mospërputhesh dhe kërkesash kufizuese të përfshira në dosjen e tenderit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar asnjërin nga çështjet e ngritura, por është kufizuar në përgjigjen e përgjithshme "referoju DT-së", pa ofruar asnjë arsyetim teknik apo ligjor. Për rrjedhojë, dokumentacioni i tenderit vazhdon të përmbajë kërkesa të paqarta, joproporcionale dhe kufizuese, të cilat cenojnë interesin tonë ligjor dhe pamundësojnë përgatitjen e një oferte të përgjegjshme dhe të

ARGUMENTET: Një (1) Inxhinier i Diplomr e inxhinierit osc bachelor, CV si dhe ndërtimtarisë -ose bachelor Marrëveshjen mbi angazhimin e tij. Eshtë kërkuar një inxhinier i ndërtimtarisë I-ose bachelor, ku nuk është specifikuar drejtimii A kërkohe ing me drejtim konstruktiv apo hidro. Konsiderojmë se një kërkesë e tillë është e paqartë dhe lenë hapsir për interpretime të ndryshme.

LIDHUR ME KËRKESAT MBI MUNDËSITË TEKNIKE DHE/OSE PROFESIONALE/ KËRKESA NUMER 10.

10. Për Sinjalizimi horizontal Të dorëzohet një mostër nga vertikajla dhe ,në nie nga horizontalia te dizajnit të shenjës dhe te gjitha pozicionet duhet të jete ne p#rputhshmëri sipas Udhëzimit (ë lartë punohen dhe të vendosen sipas cekur. Udhëzimit Administrativ nr.9 2019 për vendosien, formën,

Në këtë kërkesë janë kërkuar nga një mostër nga vertikajla dhe horizontalja, pa e specifikuar qartë se qfar mostre duhet të dorëzohet. Duke e përfshirë dimensionet, pamjen dhe materialin për punim të mostrës, pasi që si kriter as në Njoftim për Kontratë, DT konkretisht FTD dhe Aneksin 1 nuk është specifikuar në mënyrë të qartë. Apo mos kjo zgjedhje është lënë në duart e OE..

Në kërkesën tonë për sqarime kemi ngritur faktin se në Paramasë dhe Parallogari nuk ekziston asnjë pozicion që parasheh përdorimin e teknologjisë "spray-plastic", rrjedhimisht nuk ekziston asnjë bazë teknike dhe funksionale që justifikon kërkimin e pajisjes:

ii Makina special për sinjalizim horizontal të rrugëve me sprej-plastik SP DL me DI me ekstruder Line Advanced 50 cm",

1.Makina duhet te kete mekanizëm per vendosjen e materilet nga termoplastilca në gjersi 15 cm trashësia 1.5mm deri 3.0mm

2.Makina duhet te kete integruar edhe shpërndarjen e fosforit.

3.Makina duhet te kete mekanizëm per vendosjen e materilait nga plastika me trashësi, sipas specifikimeve teknike

4.kapaciteti mbajtës së rezervarit sprej plastikes min 300 kg

5.Makina duhet te kete mundësi qe nëpërmes ekstruderit special Dot Line të përshkruar simbolet horizontale ne madhësi të shkronjave simbole horizontale të trafikut rrugor ne madhësi të shkronjës prej 50 cm psh shkolla, taxi, bus etj.

Gjithashtu kemi ngritur se kërkesat për: ekstruder Dot Line; realizimin e shkronjave prej 50 cm;

uk ndikojnë në cilësinë dhe rezultatin final të punimeve dhe nuk burojnë nga ndonjë pozicion i Para masës. Pra, nuk parashihet puna me kërkesa të tilla.

Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim teknik dhe nuk ka identifikuar asnjë pozicion të paramasës dhe Para llogarisë që kërkon këto karakteristika. Duke kthyer një përgjigje të mangët me "REFEROJU DT". Edhe pse DT kishte paqartësi dhe mangësi në vete. Me këtë është bërë më e vështirë të përgatitet një ofertë e saktë dhe korrekte. Nga kjo vlen të theksohet se dyshimet janë të mëdha që këto kërkesa për këtë pajisje/makinë janë kaq diskriminuese/favorizuese, dhe janë të përgatitura për një OE të caktuar. Me këtë mënyrë

pamundësohet ofertimi i OE tjerë që mund ta kryejnë punën e njëjtë, me rezultate të njëjta por me pajisje ekuivalente dhe bash kohore. Rrjedhimisht, rezulton se Njësia Kërkuese ka përfshirë në dokumentacion një specifikim teknik pa ndonjë arsyetim të qartë teknik dhe pa ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka dështuar të japë sqarime dhe ta arsyetojë të njëjtin ashtu siç udhëzon LPP. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, nenin 27 dhe nenin 28 të LPP-së, si dhe me nenin 19.2 dhe 19.3 të Rregullores Nr.002/2024 për Prokurimin Publik dhe ndryshimin e Rregullores nr 001/2022 për Prokurimin Publik, pasi specifikimet teknike duhet të jenë proporcionale, të lidhura me objektin e kontratës dhe nuk duhet të kufizojnë konkurrencën apo të favorizojnë operatorë ekonomikë apo pajisje të caktuara, që mos të shkelet neni 7I LPP-së.

LIDHUR ME DYFISHIMIN E PIKAVE 2 DHE 4 TE ANEKSIT 8

Në kërkesën tonë për sqarime kemi evidentuar se pika 2 dhe pika 4 e Aneksit 8 përmbajnë përshkrim plotësisht identik, respektivisht:

Rimorkio me elemente sinjalizimi (për paralajmërim për punime në rrugë)

Për këtë arsye kemi kërkuar sqarim nëse bëhet fjalë për një gabim teknik në dokumentacion apo nëse Autoriteti Kontraktues kërkon posedimin e dy rimorkiove të veçanta me të njëjtat karakteristika. Në vend se të japë një përgjigje konkrete dhe të qartë lidhur me paqartësinë e ngritur, Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me përgjigjen e përgjithshme "referoju DT-së", ndonëse pikërisht Dosja e Tenderit përmban dy kërkesa identike dhe nuk sqaron nëse bëhet fjalë për një apo dy pajisje. Për rrjedhojë, paqartësia mbetet e pa eliminuar dhe na pamundëson të përcaktojmë me siguri numrin e pajisjeve që kërkohen për përmbushjen e kriterit. Veprime të tilla bien ndesh me nenin 53 të LPP-së, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar sqarim real ndaj pyetjes së parashtruar, si dhe cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionali të të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

LIDHUR ME "APARATIN SPECIAL TERMOPLASTIK I

Në kërkesën tonë për sqarime kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe Njësia Kërkuese të sqarojnë terminologjinë e përdorur në Aneksin 8, konkretisht kërkesën për "Aparat special termoplastik për matjen e trashësisë së termoplastikës", pasi formulimi i përdorur është teknikisht i paqartë dhe nuk identifikon qartë llojin e pajisjes së kërkuar, karakteristikat dhe funksionin e saj në kuadër të realizimit të kontratës. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues, duke u mbështetur në qëndrimin e Njesisë Kërkuese, nuk ka ofruar asnjë sqarim konkret, duke lënë në fuqi një kërkesë të paqartë dhe teknikisht të pakuptueshme. Rrjedhimisht, Njësia Kërkuese ka hartuar një specifikim të paqartë, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka dështuar të përmbushë obligimin e tij për të dhënë sqarime të plota dhe të arsyetuara duke shkelur nenin 53 të LPP-së. Për rrjedhojë, konsiderojmë se një kërkesë e tillë e paqartë cenon sigurinë juridike, krijon hapësirë për interpretime të ndryshme gjatë fazës së vlerësimit dhe bie ndesh me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së

LIDHUR ME MBI VENDOSJEN E PIKES I DHE PIKES 7 TE ANEKSIT 8

2.Makina duhet te kete intepruar edhe shpërndarjen e fosforit.

3, Makina duhet te kete mekanizëm per vendosjen e materialit nga plastika mc trashësi, sipas specificeve teknike

4.. Kapaciteti mbajtës i rezervarit prej plastike min 300 kg

5.Makina duhet te kete mundësi qe nëpërmes extruderit special Dot linë përshkruaj simbolet horizontal. ne madhësi te shkronjave sinbole horizontale të trafikut rrugor ne madhësi tu shkronjës prej Sa cm si psh, 51k011a, taxi, bus eti,

Makinë masë termoplastik për sinjalizim horizontal te trafikut rrugor (i5huj, dhe pronësi apo me elemente tjera horizontale) me marrëveshje

Në kërkesën tonë për sqarime kemi ngritur paqartësinë se pika 1 dhe pika 7 1 referohen aplikimit të masës term plastike dhe nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për dy pajisje të ndryshme apo për të njëjtën pajisje. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues është mjaftuar me përgjigjen "referoju DT-se, pa dhënë asnjë sqarim konkret

Për rrjedhoj, mbetet e paqartë se çfarë pajisjesh kerkohen realisht për përmbushjen e këtij kriteri , gjë ndikon drejtpërdrejt në përgatitjen e ofertës.

Ky mosveprim ble ndesh me nenin 53 dhe nenin 28 te LPP-së

LIDHUR ME KERKESEN PER MAKINEN QE APLIKON TRI VIJA NJEKOHESISHT

pajisja do te përbëhet një aparat për pastrimin e sipërfaqeve, një makinë mekanike për sliënim rrugës dite të gjitha pajisjet shtesë të nevojshme për operim me dorë për kompletimin e punës, Makina mekanike për

me një të trashësi uniforme të trasllësise se filmit në normat e zbatimit të specifikuar më tutje

Në Specifikimet Teknike faqe 56, Njësia Kërkuese ka përcaktuar që makina mekanike për shënimin e rrugëve duhet të jetë në gjendje të aplikojë së paku tri vija njëkohësisht. Në kërkesën tonë për sqarime kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe Njësia Kërkuese të sqarojnë bazën teknike dhe funksionale të kësaj kërkesë, të identifikojnë pozicionet konkrete të para masës dhe Para llogarisë ku kërkohet ky funksionalitet, si dhe të sqarojnë nëse pranohen pajisje profesionale që sigurojnë të njëjtin rezultat përfundimtar. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues, duke u mbështetur në qëndrimin e Njesisë Kërkuese, nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe nuk ka identifikuar asnjë pozicion të para masës dhe Para llogarisë që justifikon një kërkesë të tillë. Rrjedhimisht, rezulton se Njësia Kërkuese ka përfshirë në dokumentacion një specifikim teknik pa ndonjë arsyetim të qartë teknik dhe pa ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka dështuar të japë sqarime dhe ta arsyetojë të njëjtin.

Veprime të tilla bien ndesh me nenin 7, nenin 27, nenin 28 dhe nenin 53 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 40 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, sipas të cilit specifikimet teknike duhet të jenë objektive, proporcionale, të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos krijojnë kufizime të panevojshme të konkurrencës. Për rrjedhojë, konsiderojmë se kjo kërkesë është vendosur në mënyrë arbitrare nga Njësia Kërkuese, pa justifikim profesional dhe pa mbështetje në Panamasë dhe Para llogari, duke krijuar kufizime të pajustificuara në konkurrencë dhe duke cenuar parimet themelore të prokurimit publik

LIDHUR ME KERKESAT MBI MUNDESIT TEKNIKE DHE/ OSE PROFESIONALE NUMER 12 DHE ANKEKSI 8

12. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknilce që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 8-të i DT-së.

12. Lisia e pajisjeve profesionale të OE. Dubet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Elconomik (referoju Listës se pajisjeve ne Aneksin 8 të DT-së)

-Vërejte; Makinat e kërkuara duhen të dëshmohen me dokumentacion valid, fotografi tyre, (dud doganor (dhe do të testohen në prezencë të komisionit gjatë vlerësimit nga komisioni i caktuar nga AK

Sipas Aneksi 8 është kërkuar që pajisja/makineria të dëshmohen me dokumentacion valid si dhe të testohen në prezencë të komisionit gjatë vlerësimit. Ky kriter është diskriminues në disa aspekte, një shembull konkret e kemi: në qoftë se një pajisje/makineri merret nga një shtet i huaj, me marrëveshje qiraje, është e vështirë e realizueshme dhe e kushtueshme nga ana e AK për testim të pajisjes në vendndodhje të pajisjes/makinerisë. Pasi që pajisja/makineria ndodhet në Shtetin e huaj dhe ajo sillet në vend punishte vetëm nëse OE është i rekomanduar për nënshkrim të kontratës. Përndryshe verifikimi i pajisjes/ makinerisë para nënshkrimit të kontratës përbën kosto të panevojshme dhe barë të rëndë financiare për Autoritetin Kontraktues. Duke pasur parasysh që Komisioni vlerësues duhet të shkoj në shtetin e huaj, konkretisht vendin ku ndodhet pajisja për ta testuar atë, kjo gjë përbënë shkelje të nenit 1, konkretisht pika 1 të LPP: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Lidhur me këtë, duke iu referuar nenit 55 të LPP-së, si dhe nenit 76 të RRUOPP-së mund të përdor edhe metoda elektronike për verifikimin të saktësisë qoftë saktësisë dokumentare dhe po atë të gjendjes së pajisjes. Duke ia lehtësuar në këtë formë edhe OE të huaj pjesëmarrjen në këtë procedurë, gjë që mbështetet me nenin 71 të LPP-ë.

LIDHUR ME STANDARDET EN

Në kërkesën tonë për sqarime kemi ngritur faktin se standardet EN 12966, EN 12352, EN 12368 dhe EN 12675 që janë kërkuar në Specifikacion Teknik në faqe 36 m dhe të njëjtat kanë të bëjnë me sistemet VMS, pajisjet ndriçuese dhe semaforët, ndërsa pas analizimit të para masës dhe Para llogarisë nuk rezulton se ekzistojnë pozicione punimesh që lidhen me këto elemente. Për këtë arsye, kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe Njësia Kërkuese të sqarojnë nëse këto standarde janë të detyrueshme, me cilat pozicione të para masës dhe Para llogarisë lidhen, si dhe cili dokument do të ketë përparësi në rast të mospërputhjeve ndërmjet Specifikimeve Teknike dhe para masës. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues, duke u mbështetur në qëndrimin e Njesisë Kërkuese, nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe nuk ka arsyetuar lidhjen ndërmjet këtyre standardeve dhe objektit të kontratës. Rrjedhimisht, Njësia Kërkuese ka përfshirë në dokumentacion standarde teknike p? përcaktuar bazën e tyre funksionale dhe pa dëshmuar lidhjen e tyre me punimet e parapara, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka dështuar të ofrojë sqarimet e nevojshme për interpretim të njëjtë të dokumentacionit. Për rrjedhojë, konsiderojmë se përfshirja e standardeve të lartcekura pa ndonjë lidhje të qartë me Para masën dhe Para llogarinë cenon sigurinë juridike, krijon paqartësi gjatë përgatitjes së ofertave dhe rrezikon trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë gjatë fazës së vlerësimit

LIDHUR ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV KËRKUAR NË DT KRITERI NR 10 DHE 11

10- Për Sinjalizimin horizontal dhe vertikal të trafikut rrugor, në të gjitha pozicionet duhet të punohen dhe vendosen sipas Udhëzimit nr.9 2019 për vendosjen, formen, dimensionet e shenjave dhe sinjalizimet rrugor alle është pjesë e dosjes. Kurse tjera janë specifikuar në pozicionet e paramasës si dhe përshkrimit teknik që është pjesë e dosjes

Të dorëzohet një mostër nga vertikajla dhe një nga horizontalja të dizajnit të shenjës dhe jete në përputhshmëri sipas Udhëzimit të cëkur.

Për rregullirni i punishtes me sinj gjatë ekzekutimit të shenjave dhe përgjigjeve tjera të bëhet sipas dispozitave ligjore për trafik, ku obligohet të plotësoj kushtet përpikërimi sinjalizimi i vend-punishtes, shenjat e lajmërimit për punime në rrugë dhe orientimi i trafikut duhet të bëhet konform Ligjit për Siguri të Komunikacionit Rrugor (Nr.05 L-088) Udhëzimit Administrativ (Nr.09 2017).

Të dorëzohet Propozimi - përshkrimi i planit për menaxhimin e trafikut nga inxhinieri i komunikacionit rrugor gjatë realizimit të projektit, Të jetë sa më i detajuar vërtetuar dhe i nënshkruar.

Në kërkesën tonë sqarime kemi evidentuar se dokumentacioni i tenderit referon njëkohësisht Udhëzimin Administrativ nr.09/2017 dhe Udhëzimin Administrativ pa përcaktuar qartë se cili akt nënligjor është i zbatueshëm. Kujtojmë që UA 10/2025 Që KA HYRË NË FUQI DATEN 29.12.2025 ka shfuqizuar UA 09/2017, gjithëashtu kujtojmë faktin që Ministria e Infrastrukturës në vitin 2019 nuk ka nxjerr asnjë akt ligjor

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kërkesat për stafin dhe makinerinë si dhe standardet e cilësisë janë absolutisht të domosdoshme për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efektive dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuar ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike termet e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 113 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të Mera në bashkëpunim me njësinë kërkuar i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termet e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet, Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij, Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të kësaj vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të kësaj vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2, të RRPP,

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.07.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0460 ndërsa me datë 17.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0460, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të

tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “TRAFFIKS VA SH.P.K”. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0460 ka vlerësuar si në vijim:

Vlersimi i ekspertit lidhur me afatin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim .

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se kërkesa për rishqyrtim është trajtuar nga AK dhe vendimi lidhur me këtë kërkesë i është komunikuar operatorit ekonomik. Eksperti vlerëson se AK e ka ushtruar kompetencën e tij për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesën për rishqyrtim, prandaj kjo rrethanë mund të konsiderohet si qeshtë procedurale pa ndikuar domosdoshmerisht në vlefshmerinë e vendimit përderisa nuk konstatohet se ka shkaktuar cenim të të drejtave të palëve apo parimeve të procedurës së prokurimit.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 1.

Duke shqyrtuar pretendimin ankimor dhe duke u bazuar në kërkesat e DT-së të hartuara nga AK mendoj se kërkesa e tillë nuk është diskriminuese apo e paqartë pasi që në DT konkretisht tek: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në kërkesën nr 2 është kërkuar Një (1) Inxhinier i Komunikacionit Rrugor ose bachelor mendoj se kjo kërkesë ka i përgjigjet natyrës së aktivitetit të prokurimit dhe mendoj se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 2.

Sa i përket mostrave mendoj se në specifikat e DT-së duhet të përcaktohet lloji i mostrës modeli dhe dimenzioni i cili duhet të dorzohet në AK ky pretendim ankimor është i bazuar, rekomandoj që të përmirsohet DT dhe të specifikohen mostrat.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 3.

LIDHUR ME KËRKESËN PËR MAKINËN "SP DL ME EXTRUDER DOT LINE ADVANCED 50 CM"

Nga shqyrtimi i dosjes së tenderit është konstatuar se AK ka përcaktuar specifikimin teknik SPDL me Extruder Dot Line Advanced 50 cm si kërkesë fikse. Një kërkesë e tillë kufizon konkurrencën pasi i referohet një kërkesë specifike që mund të identifikoj një produkt ose teknologji të caktuar. Për rrjedhojë pretendimi ankimor është i bazuar. Rekomandohet se AK ta rishikoj dhe ta ndryshoj këtë specifikim teknik duke e formuluar në baze të karakteristikave

funkionale ose duke lejuar produkte ekuivalente në mënyrë që të sigurohet konkurrencefektive dhe trajtim i barabarti OE.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 4.

Pasë analizes se kërkesës mendoj se është bërë një gabim në përshkrim dhe rekomandoj që të sqarohet a është gabim në përshkrim apo është menduar të kërkohej sasia 2 copë. Ky pretendim vlerohet si i bazuar

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 5.

Mendoj se ky pretendim ankimor është i pabazuar sepse gjatë hulumtimit kam vërejtur se në treg gjenden aparat special termoplastik .

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 6.

LIDHUR ME MBIVENDOSJEN E PIKES 1 DHE PIKES 7 TE ANEKSIT 8

Pas analizes se pretendimit ankimor për pikat 1 dhe 8 mendoj se u sqaru në përgjigjet 3 dhe 5 dhe nuk dot leshohet me gjatë në këto dy pika.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 7.

LIDHUR ME KËRKESËN PËR MAKINËN QË APLIKON TRI VIJA NJËKOHËSISHT Pajisja do të përbëhet nga një aparat për pastrimin e sipërfaqeve, një makinë mekanike për shënim të rrugës dhe të gjitha pajisjet shtesë të nevojshme për operim me dorë për kompletimin e punës. Makina mekanike për shënim të rrugëve do të jetë në gjendje të lyej/shtrij së paku tri vija të njëjtën kohë dhe do të aplikojnë ngjyra me një trashësi uniforme të trashësisë së filmit në normat e zbatimit të specifikuar më tutje.

Duke u bazuar në kërkesën e DT-së mendoj se pretendimi ankimor është i pabazuar pasi që në kërkesë nuk specifikohet sakt sa vija duhet të bëjë në të njëjtën kohë por kërkohej SE PAKU TRI VIJA .

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 8.

Pas shqyrtimit dhe analizes se kërkesës së DT të lartshenur eksperti mendon se ky pretendim ankimor është pjesërisht bazuar sepse mendoj se mjetet të cilat janë në pronesi apo merren me marrveshje janë lehtë të verifikueshme dhe të testueshme nga komisioni përmes dokumentacionit apo edhe fizikisht ndërsa sa i përket mjeteve të cilat gjenden me marrveshje nga OE pjesëmarrës nga vendet e huaja rekomandoj që të verifikohen nga komisioni mirpo të hiqet nga vërejtja e shënuar testimi i tyre, prandaj nga këto rrethana rekomandoj se kjo pjesë të përmirsohet dhe të largohet nga vërejtja e shënuar nga AK në DT.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 9.

LIDHUR ME STANDARDET EN

Duke analizuar natyrën e AP dhe kërkesat e DT-së po ashtu edhe pretendimin ankimor eksperti mendon se ky pretendim ankimor është i pabazuar si dhe mendon se edhe kjo kërkesë është në diskrecionin e AK dhe nevojave që i parasheh në terren.

Përgjigja në Pretëndimin ankimorë 10.

LIDHUR ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV KËRKUAR NË DT KRITERI NR 10 DHE 11

Pretendimi akimor sa i perket kërkesës nr 10 te DT-së është sqaruar ne pergjigjen nr 2 ,ndersa sa i perket kerkeses se atakuar me nr 11 eksperti shqyrtues mendon së nuk kanë te drejtë të lëshohem në cilat legjislacione punon AK i atakuar pergjegjsin e mbartin vete mirpo sa i perket ekspertit mendoj se ky pretendim ankimor është i pabazuar pasi qe nuk është kërkesë e paqart pasi qe ka specifikuar kërkesën parashkrimin e planit rregullues nga inxhinieri i komunikacionit e i cili mendoj qe është i fushes së kërkuar .

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal” me nr. të prokurimit: "616-26-3854-2-1-1", Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sikurse parashihet me dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - TRAFFIKS VA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: